

*“Unë po ju them: në qiell do të ketë po kështu më shumë
gëzim për një mëkatar që pendohet e kthehet se për të
nëntëdhjetenëntë të drejtë, që s’kanë nevojë të kthehen.”*

JEZUSI I NAZARETIT – UNGJILLI SIPAS LUKËS 15, 7



Kisha e Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 2 SHKURT 2017 Çmimi 30 lekë



ATA JANË FËMIJË! NUK JANË SKELLEVËR!

URAT



8 shkurt, Dita Ndërkombëtare e Lutjes dhe Ndërgjegjësimit
kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Mesazhi i Atit të Shenjtë
FRANÇESKUT për
Kreshme 2017
Fjala është një dhuratë.
Tjetri është një dhuratë *faqe 3-4*

Imzot Gjergj Frenco
Arqipeshkëv Metropolit
i Tiranë-Durrës të gjithë
meshtarëve, rregulltarëve,
rregulltareve dhe besimtarëve *faqe 4*

Vizita baritore e
Ipushkevit dioqezan
Nga Gjergj META *faqe 5*

Fillimi i vizitave baritore
të Arqipeshkëvit në
famullinë e Bilajve *faqe 6*

Eshtrat e të Lumit Vinçenc
Prennushi O.F.M. nderohen
për një javë në Katedralen e
Shën Palit *faqe 7*

Dita Ndërkombëtare e
Lutjes dhe Ndërgjegjësimit
kundër Trafikimit të
Qenieve Njerëzore
Nga Alfred MATOSHI *faqe 8*

Po kungohemi me Jezusin,
apo thjesht po hamë oste?
Nga Dom Marjan LUMÇI *faqe 10*

Dele të humbura,
apo ujë grabitqarë?
Dëshmitarët e Jehovahit?!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI *faqe 11*

Kalendari Liturgjik

Mars 2017

Mësimi mbi lëmoshën

Mateu 6, 1-8.



“Ruanu se i bëni veprat e mira tuajat në sy të njerëzve për t’u parë prej tyre! Përndryshe nuk do të keni fare shpërblimi te Ati juaj që është në qiell.

Prandaj, kur të ndash lëmoshë, mos i bjer borisë para vetes, sikurse bëjnë shtiracakët në sinagoga dhe në rrugë të madhe për të qenë nderuar prej njerëzve. Për të vërtetë po ju them: u ndanë me atë shpërblim! Ndërsa ti, kur të bësh lëmoshë, të mos dijë e majta çfarë bën e djathta, që lëmosha jote të jetë e fshehtë, e Ati yt që sheh në fshehtësi, do ta shpërblejë.”

Mësimi mbi lutjen

“Kur të thoni uratë, mos bëni si shtiracakët, të cilëve u pëlqen të luten në këmbë në sinagoga dhe në sheshe të rrugëve, që t’i shohin njerëzit. Përnjëmend po ju them: u ndanë veç me atë shpërblim! Ndërsa ti, kur të lutesh, hyr në dhomën tënde, mbylle pas vetes derën e lutju Atit tënd që është në fshehtësi; e Ati yt që sheh në fshehtësi, do të të shpërblejë.

E kur të thoni uratë, mos teproni me fjalë të kota porsì paganët: ata mendojnë se do t’u plotësohet urata nëse thonë shumë fjalë. Mos bëni si ata, sepse Ati juaj e di mirë se për çka keni nevojë para se t’i luteni.

1 mars – E MËRKURA E PËRHIME

4 mars – Sh. Kazimiri

5 mars – E DIELA e I e KREZHMEVE (A)

7 mars – Sh. Perpetua dhe Felicità

8 mars – Sh. Gjoni i Hyjit

12 mars – E DIELA e II e KREZHMEVE (A)

17 mars - Sh. Patriku

18 shkurt - Sh. Cirili i Jeruzalemit

19 mars – E DIELA e III e KREZHMEVE (A)

20 mars – Sh. JOZEFI

25 mars – LAJMËRIMI I ZOTIT

26 mars – E DIELA e IV e KREZHMEVE (A)



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frenco

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija
Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D’Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Mesazhi i Atit të Shenjtë FRANÇESKUT për Kreshme 2017

Fjala është një dhuratë. Tjetri është një dhuratë

Të dashur vëllezër e motra,

Kreshma është një fillim ri, një udhë që na çon drejt një pikëmbërritje të sigurtë: *Pashka e Ngjalljes, fitorja e Krishtit mbi vdekjen*. Gjithmonë kjo kohë na drejton një grishje të fuqishme për kthim: i krishteri është i thirrur të kthehet te Hyji “me gjithë zemër” (Jl 2,12), që të mos mjaftohet me një jetë mediokër, por të rritet në miqësi me Zotin. Jezusi është miku besnik që nuk na braktis kurrë, sepse, edhe kur ne mëkatojmë, ai pret me durim kthimin tonë e me këtë pritje ai na shfaq vullnetin për të na falur. (krh., *Homelia në Meshën e shenjtë*, 8 janar 2016).

Kreshma është një kohë e përshtatshme për të fuqizuar më shumë jetën e shpirtit nëpërmjet atyre instrumenteve të shenjta që Kisha na ofron: *agjërimin, lutjen dhe lëmoshën*. Në bazë të të gjithave qëndron Fjala e Hyjit që në këtë kohë jemi të thirrur ta dëgjojmë dhe ta meditojmë me më shumë vëmendje. Në mënyrë të veçantë këtu, do të doja të ndalesha në shëmbëlltyrën e të pasurit dhe Lazrit të varfër (krh. Lk 16,19-31). Ta lëmë veten të frymëzohemi nga kjo pjesë kaq domethënëse që na ofron një çelës për të kuptuar se si të veprojmë që të mbërrijmë lumturinë e vërtetë dhe jetën e pasosur, duke na porositur për një kthim të sinqertë.

1. Tjetri është një dhuratë

Shëmbëlltyra fillon duke na paraqitur dy personazhet kryesore, por i varfëri përshkruhet në mënyrë më të hollësishme: ai ndodhet në një gjendje të dëshpëruar e nuk ka fuqi të ngrihet, qëndron te dera e të pasurit dhe han thërrimet që bien nga tryeza e tij, e ka trupin të mbushur me plagë dhe qentë ia lëpijnë ato (krh. vv.20-21). Situata paraqitet e trishtë dhe ky njeri është i degraduar e i poshtëruar.

Skena shfaqet edhe më dramatike nëse vihet re fakti që i varfëri e ka emrin Lazër: një emër i mbushur me premtime e që fjalë për fjalë do të thotë “Hyji ndihmon”. Prandaj ky personazh nuk është anonim, por ka trajta të mirëpërcaktuara dhe paraqitet si një individ i cili ka edhe një histori personale. Ndërkohë që në sytë e të pasurit ai është si një i padukshëm, për ne bëhet i njohur, e pothuajse familjar, kthehet në një fytyrë; e si i tillë është një dhuratë, një pasuri e paçmueshme, një qenie e dashur, e dashuruar, për të cilin Hyjit i bie ndërmend edhe pse gjendja e tij konkrete është ajo e një refuzimi njerëzor (krh., *Homelia në Meshën e Shenjtë*, 8 janar 2016).

Lazri na mëson që *tjetri është një dhuratë*. Marrëdhënia e duhur me njerëzit ka të bëjë me pranimin falënderues të vlerës së tyre. Edhe i varfëri në derën e të pasurit nuk është një pengesë bezdisëse, por një grishje për t’u kthyer e për të ndryshuar jetë. Ftesa e parë që na vjen nga kjo shëmbëlltyrë është hapja e derës së zemrës tonë, pasi çdo njeri është një dhuratë, qoftë i afërmi ynë e qoftë i varfëri i panjohur. Kreshma është



një kohë e volitshme për t’ia hapur dyert çdo nevojtarit dhe për të dalluar te ai apo te ajo fytyrën e Krishtit. Secili prej nesh ka rast t’i takojë në rrugën e tij. Çdo jetë që na del para është një dhuratë dhe meriton praninë, respekt, dashuri. Fjala e Hyjit na ndihmon të hapim sytë për të pranuar jetën dhe për ta dashur, sidomos kur ajo është e brishtë. Por, për të bërë këtë gjë, është e nevojshme të merret seriozisht edhe ajo çka ungjilli na zbulon kur flet për njeriun e pasur.

2. Mëkati na verbon

Shëmbëlltyra është e pamëshirshme kur evidenton kundërshtitë në të cilat gjendet i pasuri (krh. v.19). Ky personazh, ndryshe nga Lazri i varfër, nuk ka një emër, dhe është i cilësuar vetëm si një “i pasur”. Tepria e tij shfaqet në petkat që mban veshur, janë të një luksit të tepruar. Mëndafshi në fakt ishte shumë i kushtueshëm, më shumë se argjendi e ari, dhe prandaj ishte i rezervuar për hyjnitë (krh., Jer 10,9) dhe për mbretërit (krh., Gjyq 8,26). Pëlhura ishte një li i veçantë që ndihmonte të dukej qëndrimi sa më i shenjtë. Pra pasuria e këtij njeriu ishte e tejskajshme, edhe sepse shpërfaqej çdo ditë, ishte bërë zakon: “Gostitej shkëlqyeshëm si një ditë për ditë” (v.19). Në të tejshihet në mënyrë dramatike prishja që vjen nga mëkati e që kryhet në tre momente të njëpasnjëshme: *dashuria për paratë, krenia dhe mendjemadhësia* (krh., *Homelia në Meshën e Shenjtë*, 20 shtator 2013).

Apostulli Pal thotë se “Rrënja e të gjitha të këqijave, veç, është lakmimi i të hollave” (1 Tim 6,10). Ai është shkaku kryesor i prishjes dhe burimi i zilive, zënkave dhe dyshimeve. Paraja mund të arrijë të na sundojë duke u kthyer kështu në një idhull tiran (krh., Nxiti. Ap. *Gëzimi i Ungjillit*, 55). Në vend që të shërbejë si mjet në shërbimin tonë, për të përmbushur të mirën dhe për të ushtruar solidaritetin me të tjerët, paraja mund të na nënshtrojë neve dhe tërë botën ndaj

një logjike egoiste që nuk i lë hapësirë dashurisë dhe pengon paqen.

Shëmbëlltyra na dëfton se si epshi i tij shfrenuar e mbush të pasurin me kreni. Personaliteti i tij realizohet vetëm në dukjen e jashtme, duke u treguar të tjerëve atë çka ai ka. Por dukja e jashtme është një maskë për zbrazëtinë e brendshme. Jeta e tij është e burgosura e jashtësisë, e përmasës më të cekët dhe më të kalueshme të ekzistencës. (krh., *Po aty*, 62).

Shkalla më e ulët e kësaj rënie morale është krenia. Njeriu i pasur vishej si të ishte një mbret, simulon sjelljet e një hyjnie, duke harruar që është thjesht një vdekatar. Për njeriun e prishur nga dashuria për pasurinë nuk ekziston tjetër gjë përpos un-it të tij e prandaj, për të njerëzit që e rrethojnë nuk i hyjnë në sy. Rezultati i lidhjes së ngushtë me paranë është një lloj verbërie: i pasuri nuk e sheh të varfërin e uritur, plot plagë dhe i rënë përmbys në poshtërimin e tij.

Duke shikuar këtë personazh, kuptohet pse Ungjilli është kaq i prerë kur dënon dashurinë për paranë: “Askush s’mund t’u shërbejë dy zotërinjve, sepse: ose do ta urrejë njërin e tjetrin do ta duajë, ose do t’i mbështetet njërit e tjetrit do t’ia kthejë shpinën. Nuk mund t’i shërbeni Hyjit dhe pasurisë” (Mt 6,24).

3. Fjala është një dhuratë

Ungjilli i të pasurit dhe Lazrit të varfër na ndihmon t’i përgatitemi mirë Pashkës që po afrohet. Liturgjia e të Mërkurës së përhime na fton të jetojmë një përvojë të ngjashme me atë që përjeton i pasuri në një mënyrë shumë dramatike. Meshtari duke hedhur hi në kokë përsërit: “*Kujtohu se je pluhur e në pluhur do të kthehesh*”. I pasuri dhe i varfëri në fakt vdesin të dy dhe pjesa kryesore e shëmbëlltyrës zhvillohet në jetën e përtëjme. Të dy personazhet papritur zbulojnë se “nuk kemi sjellë gjë në botë e nuk mund të marrim asgjë me vete” (1 Tim 6,7).

Edhe shikimi ynë i hapet jetës së përtejme ku i pasuri ka një dialog të gjatë me Abrahamin, të cilin e thërret “atë” (Lk 16,24.27), duke treguar kështu se është pjesë e popullit të Hyjit. Kjo veçanti e bën jetën e tij edhe më në kundërshti, sepse deri tani nuk ishte thënë asgjë në lidhje me marrëdhënien e tij me Hyjin. Në të vërtetë në jetën e tij nuk kishte vend për Hyjin, i vetmi hyj i tij ishte vetvetja.

Vetëm midis vuajtjeve në jetën e përtejme i pasuri e njuh Lazrin dhe do të donte që i varfëri të lehtësonte vuajtjen e tij me pak ujë. Gjestet e kërkuara prej Lazrit janë të ngjashme me ato që mund të kishte bërë i pasuri, por që nuk i ka bërë. Abrahami megjithatë ia shpjegon: “...se ti i gëzove të mirat e tua gjatë jetës sate, ndërsa Lazri të këqijat; tashti, ky këtu gëzon e ti vuan” (v.25). Në jetën e përtejme rivendoset një lloj barazie dhe të këqijat e jetës ekuilibrohen nga e mira.

Shëmbëlltyra vazhdon dhe paraqet kështu një mesazh për të gjithë të krishterët. Në fakt i

pasuri, i cili ka ende disa vëllezër gjallë, i kërkon Abrahamit të dërgojë Lazrin te ata për t'i qortuar; por Abrahami i përgjigjet: “kanë Moisiun dhe profetët; le të dëgjojnë ata” (v.29). E përballë vërejtjes së të pasurit, shton: “Nëse nuk dëgjojnë Moisiun dhe profetët, nuk do të binden as nëse dikush ngjallet prej të vdekurish” (v.31).

Në këtë mënyrë del në pah problemi i vërtetë i të pasurit: rrënja e të këqijave të tij është se nuk ia vë veshin Fjalës së Hyjit; kjo ka bërë që ai të mos e dojë më Hyjin dhe kështu të përçmojë të afërmin. Fjala e Hyjit është një forcë e gjallë, e aftë të ngjallë kthimin në zemrën e njerëzve dhe të drejtojë sërish zemrat të Hyji. T’ia mbyllësh zemrën dhuratës së Hyjit që flet ka si pasojë mbylljen e zemrës ndaj dhuratës së vëllait.

Të dashur vëllezër e motra, Kreshma është një kohë e përshtatshme për t’u përtërirë në takimin me Krishtin e gjallë në Fjalën e tij, në Sakramentet dhe në të afërmin. Zoti – që në dyzet ditët e kaluara në shkretëtirë ka fituar mbi

mashttrimet e Tundesit – na tregoftë rrugën në të cilën duhet të ecim. Shpirti Shenjtë na udhëheqte në përmbushjen e një rrugëtimi të vërtetë kthimi, për të zbuluar sërish dhuratën e Fjalës së Hyjit, për t’u pastruar nga mëkati që na verbon dhe për t’i shërbyer Krishtit i cili është i pranishëm në vëllezërit në nevojë. Inkurajoj të gjithë besimtarët që ta shprehin këtë përtëritje shpirtërore duke marrë pjesë në Fushatat e Kreshmës që shumë organizma krishtarë, në shumë anë të botës, promovojnë që të rritet kultura e takimit në të vetmen familje njerëzore. Të lutemi njëri për tjetrin në mënyrë që, pjesëmarrës në fitoren e Krishtit, të dimë t’ia hapim dyert tona të dobët dhe të varfrit. Atëherë do të mund të jetojmë e të dëshmojmë plotësisht gëzimin e Pashkës.

Nga Vatikani, 18 tetor 2016
Festa e Shën Lukës Ungjilltar

Françesku

IMZOT GJERGJ FRENDO ARQIPESHKËV METROPOLIT I TIRANË-DURRËS TË GJITHË MESHTARËVE, RREGULLTARËVE, RREGULLTAREVE DHE BESIMTARËVE

Fort të dashur,

Kjo është herë e parë që po ju drejtohem juve si arqipeshkëv. Kanë kaluar gati tre muaj nga ajo ditë kur jam shpallur bariu i kësaj Arkidioqeze. Gjatë kësaj periudhe kam vënë re sa bukur dhe sa e dobishme është të jem afër popullit dhe ta dëgjoj. Kam filluar vizitat baritore nëpër famullitë e dioqezës dhe e para ishte në famullinë e Bilajt. Në një takim që kisha me të rinjtë i kam pyetur: “Çka prisni prej ipeshkëvit?” Dhe një vajzë është përgjigjur: “Që të jesh më afër nesh”. Dhe unë shtoj: “Jo vetëm të jem afër popullit, por edhe të dëgjoj zërin e popullit”. Ja pse në stemën time kam zgjedhur fjalët: “Bariu dëgjoftë zërin e deleve”.

ZËRI I ZOTIT

Të dashur vëllezër e motra, edhe tri ditë, e do të fillojmë kohën e shenjtë të Kreshmëve. Është koha në të cilën të gjithë jemi të nxitur ta dëgjojmë zërin e Zotit. Në fakt, zërin e Zotit e dëgjojmë vazhdimisht, sidomos në takimin tonë me të, ditën e dielë. Por Kreshmët janë koha e privilegjuar në të cilën Zoti bërtet me zë më të fortë: “Kthehuni! Besojini ungjillit! Ejani tek unë, dhe unë do t’ju çlodh! Duajeni njëri tjetrin sikurse unë ju desha ju!”

Fillojmë Kreshmët me një kremtim për të cilin vijnë shumë njerëz. Kishat tona, atë ditë, do të jenë plotë me njerëz. Atë ditë agjërojmë, dhe në meshë bekojmë hirin, që pastaj vendoset mbi kokat tona. E gjithë kjo tregon se ajo ditë, E Mërkura e Përhime, nuk është një ditë e zakonshme. Është një ditë e veçantë, shumë e veçantë. Sa e bukur është ajo ditë, në të cilën, së bashku, si komunitet dhe si individë, pranojmë të vërtetën: jemi mëkatarë! Kemi nevojë për falje! Megjithatë lajmi i Kreshmëve mbetet një lajm i mirë. Pse?

Shumë besimtarë mendojnë se Kreshmët janë kohë që na përgatit për përkujtimin e mundimeve dhe të vdekjes së Krishtit. Në fakt, është koha që

na përgatit për Pashkët e Ngjalljes. Do të ngjallemi me Krishtin. Por që të ngjallemi me Krishtin duhet edhe të vdesim me Krishtin. Krishti vdiq për mëkatin. Ashtu edhe ne duhet të vdesim për mëkatin, që të mund të ngjallemi me Krishtin. Në Librin e Kishtarit lexojmë se “ka kohë për të lindur e kohë për të vdekur”. Kreshmët na thonë se “ka kohë për të vdekur dhe kohë për të rilindur”. Pra të përgatitemi për rilindje.

Vërtetë, është e bukur koha e Kreshmëve, që na forcon në shpresë. Sepse Zoti, si Atë i mëshirshëm, edhe duke ditur se jemi mëkatarë, në thërret, na përqafon, duke na thënë: “Je im bir, jam yt at. Je i falur. Unë të dua”.

PËRVOJA E FALJES

Jezusi e ka përshkruar mirë misionin e tij kur thotë: “Nuk erdha për të dënuar, por për të shpëtuar”. Në Psalmin 51 themi: “Mëkatin tim e kam përherë para sysh”. Është e vërtetë, mëkatin tonë e kemi gjithmonë para sysh, jo thjesht *si mëkat*, por *si mëkat të falur*. Duhet të falim e të harrojmë, por nuk duhet të harrojmë se jemi mëkatarë të falur. Përvoja e dashurisë atërore të Zotit, që tregohet veçanërisht në faktin që Ai na i fal mëkatet, duhet të na forcojë drejt asaj dashurie heroike që të falim të tjerët. Të gjithë kemi pasur, dhe vazhdimisht përjetojmë, këtë eksperiencë të faljes nga Zoti. Qoftë kjo përvojë ajo forcë që na nevojitet që edhe ne të falim.

Shoqëria jonë ka nevojë për dëshminë tonë si apostuj të faljes. Në botën e sotme kush mund të shpallë lajmin e mirë të dashurisë dhe të faljes më shumë dhe më mirë se Kisha e Krishtit? Por sa e dhimbshme kur shohim mijëra fëmijë të ngujuar për shkak të frikës së gjakmarrjes! U mohohet e drejta për arsimin, për një jetë të qetë, për t’u shoqëruar me shokët, sepse është dikush mizor që i kërcënon për t’u hakmarrë për një vrasje që ka ndodhur para shumë vitësh në familjen e tij.

Anton Luli ishte një prift jezuit i cili u burgos dhe u torturua barbarisht nga shokët e shokut Enver. Duke folur për eksperiencën e tij në burgjet ku kaloi gati njëzet vjet tha: “Due me theksue nevojën e faljes së krishtenë. Në kjoftë se Shqipëria do mëkambet si popull, duhet me u mëkëmbë me anë të faljes. ... Fill mas liritim kam pasë rast me e zbatue këtë urdhën të Zotit. Kam takue atë brigadierin që, sipas thanjeve të shumëkujt, ka kenë përgjegjësi kryesor dhe autori i burgimit tem. E kam përshëndetë, e kam puth në faqe, pa i dhanë asnjë shejë për të kaluemen. Ai ma ka kthye e me një buzëqeshje”.

A mund të bënim një gjest të tillë ne, një gjest aq kurajoz? Falja tregon sa të fortë jemi në dashuri. Falja tregon sa jemi të mbushur me shpirtin e Krishtit. A nuk kishte ai mundësi të hakmerrej nga ata që e kishin dënuar dhe kryqëzuar? Megjithatë, nga kryqi është lutur për ta: “Fali, o Atë!”

Të dashur vëllezër e motra, le të ndërtojmë ura që na bashkojnë, dhe assesi mure që na ndajnë. Krishti ka shembur murin e ndarjes. Mos të jemi ne që ndërtojmë mure të reja!

Së fundi ju kujtoj detyrën tonë të mbajmë agjërim të Mërkurën e Përhime e më pas të Premten e Madhe. Janë të detyruar të agjërojnë në këto dy ditë të gjithë ata që kanë mbushur moshën 18 vjeç deri në 60 vjeç. Mosngrënia e mishit është e detyrueshme për të gjitha të premtet e kreshmeve për të gjithë ata që kanë mbushur 14.

Duke ju uruar çdo të mirë shpirtërore gjatë kësaj periudhe të shenjtë, ju përcjell bekimin tim baritor.

Dhënë nga Kuria Arqipeshkvnore, sot më 20 shkurt 2017.

✠ **George Frenko O.P.**
Arqipeshkëv Metropolit i Tiranë-Durrës

Vizita baritore e Ipeshkevit dioqezan

Nje sintezë e historisë dhe aktualitetit të saj në dioqezën Tiranë - Durrës

Nga Gjergj META

Një nga aktet dhe veprimet e para të Imozt Gjergj Frenos ka qenë dëshira dhe vullneti i tij për të bërë vizitën baritore në të gjitha famullitë e Dioqezës Tiranë – Durrës. Po çfarë është vizita baritore dhe cila është historia e saj?

Ipeshkëvi domenikan i Bragës në Portugali, Bartolomeo de Martyribus (1559-1590) e quan vizitën baritore të ipeshkëvit në dioqezë *anima regiminis episcopalis – shpirtin e veprimit ipeshkvor*. Historia e Kishës do të presë Koncilin e Trento-s për të pasur parime të qarta rreth vizitës baritore të ipeshkëvit, si një *detyrë* thelbësore e misionit ipeshkvor, edhe pse si institucion *vizita baritore* është e lashtë sa krishtërimi.

Në etimologjinë e fjalës *episcopos* (ipeshkëv) gjendet edhe vetë fjala *vizitë*. Fjala greke *episkoptomai*, nga ku ka marrë origjinën fjala ipeshkëv, ka edhe kuptimin e vizitës, atij që viziton në mënyrë të veçantë të sëmurët dhe ata që kanë nevojë. Qysh në veprat e Apostujve thuhet: “Ejani të shkojmë e të vizitojmë vëllezërit e të gjitha qyteteve në të cilat kumtuam fjalën e Zotit për të parë se si janë” (Vap 15,36). Edhe etërit e Kishës, të frymëzuar prej apostujve, në ushtrimin e shërbesës së tyre, vizitojnë bashkësitë e ndryshme. Por duhet të presim Koncilin e Tarragonës (viti 516) për të pasur një ligj të shkruar rreth vizitës baritore. Në këtë periudhë të fillimit, motivi që e shtyn ipeshkëvin të vizitojë kishën që i është besuar gjendet te nevoja e brendshme e tij për të parë dhe për të takuar bashkësitë e ndryshme.

Edhe mesjeta e njeh institucionin e vizitës së ipeshkëvit si një *e drejtë* (ius visitandi) e rëndësishme, por që sipas dokumentave të kohës përmbante edhe shumë abuzime, saqë e detyron Koncilin III të Lateranit të thotë që ata që kanë të drejtën e vizitës të mos abuzojnë me komunitetet që vizitojnë, “...por të sillen në mënyrë të tillë që të shfaqin qartësisht se nuk kërkojnë interesin e tyre, por atë të Jezu Krishtit” (Koncili Lateranens III, kan 4).

Me Koncilin e Trentos kemi një kalim cilësor, pasi nga e drejta e vizitës (ius visitandi) kalohet në *detyrën e vizitës (obligatio visitandi)*. Në Sesionin XXIV të Koncilit, e parafundit me datë 11 nëntor 1563, në kan. 3 të Dekretit të reformës, etërit e Koncilit saktësojnë tre parimet e vizitës baritore: 1) *detyrimi i vizitës*; 2) *rikthimi te ipeshkëvi i kësaj detyre baritore* (pra duhet ta bëjë personalisht); 3) *riposhimi i qëllimit baritor dhe shpirtëror të kësaj vizite*. Shumë ipeshkëvinj reformatorë, pas Koncilit të Trentos, e aktualizuan me kujdes të veçantë këtë detyrë të tyre. Mjafton të kujtojmë ipeshkëvin e Milanos, Shën Karl Borromeo. Fryma që solli Koncili i Trentos përfshiu të gjithë Kishën dhe ky institucion u shtri në të gjithë Kishën e asaj kohe, përfshi këtu edhe kishën që gjendej në trojet tona shqiptare. Kemi relacionet e këtyre vizitave të detajuara qysh me Arqipeshkëvin e Durrësit Imzot Mark Skura (1640 – 1656) e me rradhë



deri te Imzot Vincenc Prensushi (1940 – 1949).

Ka një vizitë të pandërprerë e periodike të dioqezës së Durrësit në shekujt kur Shqipëria ishte nën Perandorinë turke. Relacionet na ndihmojnë të kuptojmë situatën e Kishës, të klerit e të besimtarëve të dioqezës së Durrësit. Vizitën baritore do ta kryejë me një përpikmëri të madhe një nga ipeshkëvinjtë më të ndriçuar të Arkidioqezës së Durrësit, Imzot Raffaele D’Ambrosio (1847 – 1892), një reformator i vërtetë i kësaj dioqeze, i cili mund të krahasohet në proporcion me një shën Karl Borromeo. Nga relacionet dhe regjistrat e *status animarum* të Dioqezës së Durrësit rezulton se ai e ka vizituar dioqezën me një frekuencë gati 2 vjeçare ose të paktën çdo dy vjet ka dashur të shohë gjëndjen e regjistrave të famullive të kësaj dioqeze.

Nëpërmejt këtyre vizitave ipeshkëvinjtë preknin vetë me dorë situatat e ndryshme dhe njihnin realitetin, duke inkurajuar besimtarët, meshtarët e duke dënuar abuzime e ndryshme dhe parregullsitë, si dhe duke mësuar doktrinën e krishterë.

Kodi i të Drejtës Kanonike i vitit 1917 kishte kanonet nga 343-346, të frymëzuar nga Koncili i Trentos, të cilët i kujtonin ipeshkëvit detyrën të vizitonte krejt dioqezën së paku një herë në 5 vjet.

Koncili II i Vatikanit në dekretin për ipeshkvinjtë *Christus dominus* porositi ipeshkvinjtë që të “përmbushin si duhet detyrën e vizitës baritore” (ChD 23). Pas Koncilit është Udhëzuesi për shërbesën e Ipeshkëvinjëve, *Ecclesiae imago* në nn. 162, 166-170 që flet dhe ndalet gjëresisht në vizitën baritore të ipeshkëvit. Në këtë dokument, duke cituar Pali VI, thuhet se vizita baritore është një “akt i pranisë së atij që ka përgjegjësinë e përgjithshme të përkujdesjes për shpirtat në territorin e dioqezës”. Është një veprim apostolik për të parë me sytë e vet realitetin. Kjo vizitë baritore prek të gjithë; të gjithë dioqezën. “I drejtohet të gjithëve, bashkësive famullitare në mënyrë të veçantë. Por interesi baritor duhet të mbërrijë tek të gjithë dhe kudo; kudo ku është Kisha, madje kudo ku ka shpirta” (Pali VI).

Kodi i së Drejtës Kanonike i vitit 1983 në krahasim me kodin e vitit 1917 ndryshon më shumë në formë se sa në përmbajtje. Kanonet që flasin për vizitën baritore janë kann. 396-398.

Sot sigurisht janë të shumta format e pranisë së ipeshkëvit në dioqezë dhe magjisteri i tij shprehet në mënyra të ndryshme. Vizita baritore, në një kohë kur lëvizja dhe mjetet e komunikimit ishin shumë të kufizuara, merrte një kuptim shumë domethënës, si për ipeshkëvin ashtu dhe për besimtarët. Sot kohët kanë ndryshuar e lehtësia për të lëvizur bën që Ipeshkëvi dioqezan të gjejë edhe forma të tjera pranie, përveç vizitës baritore kanonike. Shpesh ipeshkëvi ftohet për ceremoni të ndryshme, për inaugurime objektesh, për kushte rregulltarësh që bëhen në famulli, për konferenca apo mbledhje të ndryshme.

Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri, me emërimin e Imozt Rrok Mirditës si Arqipeshkëv, është rimarrë kjo traditë e pranisë së ipeshkëvit në dioqezë. Sidomos në vitet e para prania e Arqipeshkëvit nëpër famulli në raste të ndryshme ishte shumë e shpeshtë. Tre vëllimet e homelive dhe shkrimeve të Imzot Mirditës, si dhe ato që janë në përgatitje, tregojnë frymën e gjallë të viteve të para pas rënies së komunizmit si dhe veprimtarinë e tij baritore dhe magjisteriale në dioqezë.

Imzot Gjergj Frenos, bashkë me disa akte të tjera, ka dashur që të nisë shërbesën e tij pikërisht me vizitat baritore nëpër famulli duke nisur me famullinë e Shën Gjon Pagëzuesit në Bilaj, për të vazhduar më pas me Laçin e kështu me rradhë. Një fazë e parë është përgatitja e vizitës me anë të programimit dhe të takimit të Vikarit të Përgjithshëm me famullitarin e interesuar. Gjatë vizitës ipeshkëvi kremton meshë, takon personat e angazhuar në famulli, lëvizjet e ndryshme si dhe përfaqësi të famullisë. Është kjo rruga e privilegjuar se si një ipeshkëv, bari i Dioqezës, bëhet i pranishëm në çdo realitet të kishës dioqezane.

Nëse duam të japim një përkufizim të vizitës baritore mund të citojmë tekstin e *Ecclesiae imago*:

“Vizita baritore është një veprim apostolik, është një ngjarje hiri që pasqyron në një farë mënyre shëmbëllimin e asaj vizite shumë të veçantë dhe krejtësisht të mrekullueshme, nëpërmjet së cilës “Bari i madh” (1 Pt 5,4), ipeshkëvi i shpirtave tanë (1 Pt 2,25), Jezu Krishti ka vizituar dhe ka shëlbuar popullin e tij” (*Ecclesiae imago*, n.166).

Fillimi i vizitave baritore të Arqipeshkvit në famullinë e Bilajve

Një nga elementet e veprimtarisë baritore të ipeshkvit është vizita kanonike nëpër famullitë të Dioqezës. E për këtë vit Arqipeshkvi ynë i Dioqezës ka zgjedhur të nisë vizitat e tia me zonën e famullisë “Sh. Gjon Pagëzorit” në Bilaj e rreth saj. Ky cikël vizitash, zuri fill të dielën e 12 shkurtit në fshatin Murqin. Atje, gjatë një Meshe solemne fëmijët, të rinjtë dhe përfaqësuesit e familjeve përshëndetën kryipeshkvin në mjediset e famullisë. Fëmijët me mirëseardhjen e tyre i dhuruan vizatime të punuara me dorë të lirë ku shprehej me nota të qarta fantazia, bota e kuptimi i tyre mbi fenë e rrezatimi i asaj çfarë frymëzon Jezu Krishti. Pas Meshës së shenjtë, ipeshkvi bëri bekimin e trupores së *Zojës së Papëhyer* që u vendos përballë kishës. Mesha e dytë brenda së njëjtës ditë u zhvillua në Mallkuq. Atje, në kishën e “Mëshirës Hyjnore”, Imzot Georg-it iu dha mundësia për t'u njohur ministrantët me të rinjtë e famullisë duke dëgjuar shqetësimet e gjithçka ka të bëjë me mbarëvajtjen e jetës famullitare. Ndër të tjerë, u takua edhe me autoren lokale të disa librave historikë, në të cilat është kushtuar shumë kohë dhe punë sistematike për të zbuluar e për të mbledhur të dhëna të sakta historike në shtrirjen e famullisë së Bilajt dhe fshatrave përreth.

Dëshira e bariut dioqezan, ka qenë që të njohë detajet të cilat përcaktojnë frymëmarrjen e grupeve të organizuara në baza famullitare, kështu që gjatë javës, u tubuan në një takim, personat që u përkasin grupeve apostolike si dhe ata që evidentohen më shumë në angazhimet famullitare. Të mërkurën, 15 shkurt në kishën e Bilajt erdhi breznia më e re e besimtarëve. Imzot Frendo kremtoi Meshën, ku spikati predikimi mjaft motivues e frymëzues për jetën në Krishtin. Pastaj, në shtëpinë e famullisë, u organizua një tjetër takim mjaft i ngrohtë me ministrantë, skautë, fëmijët e Marisë dhe ata të këshillit të famullisë. Ipeshkvi iu referua veprimtaria i grupit “Kustodia” anëtarët e të cilit luten për priftërinjtë që u përkasin dioqezës.

Mendoj se vizita baritore, mbetet gjith-



monë një mundësi prioritare mjaft e mirë për të thelluar marrëdhëniet me meshtarët dhe besimtarët; kësaj të premtën e 17 shkurtit ipeshkvi bashkë me famullitarin, përshkoi zonat e shtëpitë e ndryshme të fshatit duke vizituar mbi të gjithë të sëmuret. Kalimi nëpër territorin e famullisë, krijoi një tjetër mundësi për të njohur më mirë nga afër besimtarët, në kushtet e jetës së tyre dhe brenda problemeve të tyre të përditshme. Mikpritja e banorëve, thjeshtësia e tyre dhe gëzimi i sinqertë, lanë një opinion mjaft impresionant tek Imzoti. E kështu, varfëria, kushtet modeste të jetesës, mungesa e ujit dhe e energjisë elektrike, nuk i parandalojnë besimtarët katolikë të Bilajt, që të jenë njerëz të mirë dhe besimtarët të zellshëm. Ishte dita e përfundimit zyrtar të vizitës baritore, kur Kryepeshkvi Imzot George Frendo O.P. u ul bashkarisht me meshtarët dhe personelin e specializuar për t'u informuar mbi rregullin dhe mbajtjen e regjistrimeve e gjithçka që lidhet me zyrën famullitare, ku tregoi interes edhe për gjendjen ekonomike të famullisë. Pastaj shprehu dëshirën që mbylljen

e vizitës baritore ta bënte në Eukaristinë e shenjtë. Të shumë ishin besimtarët që erdhën në këtë Meshë. Me këtë rast, u paraqit edhe ish-banori i komunës, dhe eprori i Salvatorianëve në Shqipëri, at Artan Seli SDS. Ai shprehu mirënjohjen ndaj ipeshkvit, për këtë vizitë dhe falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm me kongregatën, veçanërisht, në përmasat dioqezane. E gjithmonë duhet të kemi parasysh se “Vizita baritore, është një element i rëndësishëm i shërbesës ipeshkvoe që i jep jetë dhe lidh ngushtësisht praninë shpirtërore të Ipeshkvit në mesin e besimtarëve. Janë momente të tilla, shumë afër popullit, që ushtrohet misioni i shpalljes të Fjalës, të cilat i mundësojnë ipeshkvit të shenjtërojtë dhe udhëheqë popullin e vet, dhe kështu, duke qëndruar në kontakt me njerëzit, drejtpërdrejtë, ai kupton ankthet dhe shqetësimet, gëzimet dhe pritshmëritë e tyre, duke qenë njëherësh në gjendje të ofrojë çdo fjalë shprese për jetën. Vizita baritore e kryer në këtë mënyrë, zbulon në thelbin e vet, të vërtetën, e cila është shenja e pranisë së Zotit, i cili viziton popullin e tij, duke sjellë paqe” (Pastores Gregis, 46)



Eshtrat e të Lumit Vinçenc Prennushi O.F.M. nderohen për një javë në Katedralen e Shën Palit



Në vitin 1949, ajo çka buronte në zemrën e tij prej dashurisë së pashuar në Krishtin, ia kishte paracaktuar heroikën e qëndrimit të paepur deri në martirizim. Frati, pena e brishtë e të cilit edhe sot e kësaj dite u jep ngjyrë sentimenteve humane dhe i bën të vibrojnë vrullshëm ato ndjesi artistike që prekin me dorë deri absoluten, në pozitat e primatit të Kishës Katolike në Shqipëri, por edhe si Arqipeshkëv i Durrësit e Tiranës, u vendos përballë propozimit të pështrirë të shpërndarjes së grigjës së vet për ta fragmentuar dhe shpëputur nga Kisha Universale. I dënuar me 20 vite burgim, ai vdiq nën tortura. Presionit të diktaturës për të mohuar fenë, iu përgjigj me të njëjtën mënyrë shprehje që reflektonte edhe në fuqinë e vargut: *“Pse, o mallkuem, ti don me m’hjekël/ Zëmret mue kaq-dhanti?! A se din se un di me dekël/ Per Fë shëjte, qi un ndryj n’gji?! Po, mâ mirë shtatë pash nen dhé,/ Se me bjerrun shëjten Fë... e këtë pasdite të 27 shkurtit 2017, në duart e Arqipeshkëvit Metropolitan të Shkodrës Imzot Angelo Massafra, çfarë ka mbetur pas 57 vitesh, prej eshtrave të trupit të martirizuar të Imzot Vinçenc Prennushit, vendosur në një arkivol të vogël, i drejtohet Katedrales së “Shën Palit” në zemrën e Kryeqytetit. Pranë hyrjes së Katedrales së “Shën Palit”, Arqipeshkëvi Metropolitan i Shkodër-Pulit Imzot Angelo Massafra së bashku me famullitarin e Katedrales Dom Marjan Lumçi, i cili ka dalur ta presë jashtë kishës, ndalen për një çast. Shkëmbehet përshëndetja e rastit dhe arkivoli i vogël i dorëzohet Arqipeshkëvit Metropolitan të Tiranë-Durrësit Imzot George Frendo, fare pranë hyrjes në Kishë. Më pas i ndjekur nga sytë e përqendruar të besimtarëve të shumtë, arkivoli i vogël, vendoset pranë elterit të shenjtë, në një pod të rrethuar me lule të freskëta. Sh. T. Imzot George Frendo, duke zbritur shkallët uron mirëseardhjen. Çdo veprim që kryhet pranë elterit të shenjtë flet mbi solemnitetin e momentit, që përjetohet thellësisht. Pasi kryen kemimin, Sh. T. Imzot George Frendo u drejtohet bashkëvëllezërve në kremtimin eukaristik, miqve të ardhur nga Shkodra, po sigurisht edhe besimtarëve të pranishëm, me fjalët e mirëseardhjes në këtë event mjaft të rëndësishëm e solemn. Ai bën me dije se eshtrat e pararendësit të martirizuar, në shenjë nderimi e lutjeje, do të qëndrojnë për një javë në Katedralen e “Shën Palit” e pastaj do*

të çohen në qytetin e Durrësit në kryekishën që ka qenë më përpara për të gjithë dioqezën dhe ku i ndjeri Imzot Prennushi shpалosi jetën e tij fetare. Më pas e mori fjalën Sh. T. Imzot Angelo Massafra i cili pas shprehjes “Mirësejugjeta...” bëri me dije se eshtrat e të ndjerit Imzot Prennushi, kanë kaluar trajtimin të veçantë për t’i mbrojtur nga prishja. Në Shkodër, ato u pajisën me dokumentacionin e rregullt si dhe me pergamenat. Gjithashtu besimtarëve duke ngritur dorën lart u tregoi edhe kryqin e martirëve, në të cilin është vendosur pak nga eshtrat e 10 prej 38 martirëve-shenjtër shqiptarë. Theksoi se janë vetëm 10, mbetjet nga eshtrat e trupave të gjetur, për të tjerët nuk ka asnjë gjurmë. Ai përfundoi me ftesën që t’u lutemi martirëve, të kërkojmë hiret e ata na bekoftin e lëvdofshin të gjithëve! Pas Ungjillit të shenjtë, që i përgjigjej momentit e që u lexua nga famullitari Dom Marjan Lumçi, omelinë e mbajti Sh. T. Imzot Angelo Massafra:

Qoftë lëvdur Jezu Krishti!

Sapo kemi dëgjuar Fjalën e Zotit, që është Fjalë jete dhe shprehje për të gjithë ata që besojnë në Të dhe që, në dritën e Tij, e lexojnë dhe e interpretojnë ekzistencën e tyre tokësore duke e orientuar atë kah jeta e amshuar. Në fakt, vetëm duke pasur para syve amshimin, mund ta jetojmë mirë kohën e tanishme duke bërë një jetë

të virtytshme apo duke u ngritur kur rrëzohemi dhe duke vazhduar të ecim përpara.

Atëherë shikimi kah amshimi është një shikim shprese për jetën e tanishme, gjatë të cilës u japim tepër rëndësi problemeve, deri në atë pikë sa na merret fryma prej pasigurive për të ardhmen, sikur pas jetës sonë të mos qëndronte një Atë i mirë dhe i mëshirshëm, që kujdeset për bijtë e Vet dhe që kërkon prej tyre vetëm që t’i besojnë Atij dhe të bëjnë një jetë mirë, si kemi degjuar dje në Fjalën e Zotit.

Fjala e sotme e Hyjit, përkundrazi, na hap ndaj shpresës duke na e thënë mjaft qartë se nuk ka asgjë që nuk mund të ndryshojë, asnjë situatë mëkati që nuk mund t’i hapet kthimit, asnjë realitet negativ që nuk mund të shndërrohet, sepse “asgjë nuk është e pamundur për Hyjin”. Gjithçka do të ishte më e lehtë për ne sikur me të vërtetë t’i besonim Hyjit! Sekretin është orientimi kah Hyji dhe kah jeta e amshuar që Ai dëshiron të na dhurojë.

Si t’ia bëjmë? Leximi i parë na tregon udhën e lavdit, aty ku t’i japësh lavd Hyjit nuk është vetëm një çështje fjalësh që shqiptohen me gojë dhe me këngë në kishë, por një jetë që bëhet ajo vetë lavd nëpërmjet veprave të mira. Ungjilli ka të bëjë me ndjekjen e Jezusit si mjeti i vetëm për të arritur te Hyji, por jo më përpara se të heqim dorë prej pasurive që na pengojnë të hyjmë në mbretërinë e Hyjit.





Sigurisht, pasuritë materiale mund të jenë një peshë që ngadalësojnë këtë ecje, apo madje edhe një pengesë për të arritur këtë qëllim; por nuk flasim vetëm për atë lloj pasurie: ekziston, në fakt, një lloj zotërimi që është shumë më i rëndë dhe është ai që na bën të burgosur të vetes sonë, të egoizmit tonë që përjashton të tjerët prej rrugës sonë, të krenarisë sonë që na bën ta mbajmë veten superiorë duke zënë vendin e Hyjit, të frikës sonë për të humbur dikënd apo diçka deri në atë pikë sa ndihemi të përhumbur.

Përkundrazi Jezusi na propozon një udhë lire, duke ecur së bashku me ne, madje përpara nesh meqë Ai, siç e kemi dëgjuar, na thotë: “Më ndiq!”. Pas dy ditësh do të fillojmë Kohën e

Kreshmëve, një kohë në të cilën mund të reflektojmë mbi këtë ecje lirie dhe mund ta jetojmë duke ndjekur Jezusin e tunduar në shkretëtirë, por edhe të shndërruar në malin Tabor, që i zbulohet Samaritanes si uji i vërtetë që shuan etjen për jetën e amshuar, të verbrit të lindur si drita e vërtetë dhe motrave të Betanisë si jeta e përnjëmendte.

Një ecje e vërtetë, ajo e Kreshmëve, që do të na ndihmojë të rizbulojmë vlerën e Pagëzimit, që kemi marrë dhe që, nëse e jetojmë në plotësi, mund të jetë garancia e vërtetë e jetës së mirë dhe e shpresës së madhe për jetën e amshuar. Një ecje që do të përfundojë të Shtunën e Madhe kur do të jemi të ftuar ta ripërtërijmë fenë tonë

në Krishtin e Kryqëzuar dhe të Ngjallur për të marrë pjesë në vetë jetën e Tij, në jetën e Hyjit.

Shumë të dashur, ju kemi dorëzuar trupin e të Lumit Vinçenc Prennushi, Ipeshkëv dhe Martir. Ecja e tij mbi këtë tokë, ashtu si edhe veprat e tij dhe vdekja e tij e shenjtë janë një himn për jetën dhe një hapje e madhe ndaj shpresës. Shpirti i poetit që ishte në të nuk e ka bërë vetëm një letrar të madh, por edhe një njeri të madh të Hyjit; sepse poetët e mëdhenj nuk janë ata që dinë të luajnë me fjalët, por ata që me ndjeshmërinë e tyre dinë të dallojnë të vërtetën e gjërave dhe ta kthejnë atë në rreshta që, duke i dëgjuar prej veshit njerëzor, të ngjallin emocione dhe të shtyjnë të veprosh.

Dhe, si njeri i vërtetë i Hyjit, përnjëmend i ka vënë në lëvizje shpirtat njerëzorë për ta ndjekur Jezusin me gjithë zemër, i ka përjetuar ngjarjet historike të Kombit me atë dhimbje që vetëm njerëzit e ndjeshëm si ai dinë t’i përjetojnë dhe ua ka paraqitur të gjithëve fenë e Krishtit si barkën e vetme të shpëtimit. Dhe kishte të drejtë: e ka treguar me rezistencën e vet heroike deri në martirizim, që sot e shoh si i Lumi i Kishës dhe i paraqitur të gjithëve si simbol koherence dhe qëndrueshmërie që çon në lavdi.

Duke shikuar të Lumët Imzot Viçenc Prennushi dhe 37 Shokët e tij nuk duhet të ndalemi, ju lutem, në aspektin e jashtëm, duke u kufizuar vetëm te fakti se ata janë të Lumë dhe ndoshta edhe vetëm duke u krenuar me ta; ta njohim jetën e tyre për të kuptuar se si kanë ditur ta orientojnë atë nëpërmjet fesë kah Hyji, se si kanë ditur t’u bëjnë ballë vështirësive dhe t’i tejkalojnë ato derisa kanë arritur, gati me buzë në gaz, në Martirizim dhe në Lumni.

Kështu edhe ne, të ngushëlluar prej dëshmisë së tyre, do të dimë të jemi të fortë dhe të guximshëm, persona të fesë, duke jetuar në lavdinë e Atit, në ndjekje të Krishtit Birit të Tij me fuqinë e Shpirtit Shenjt. Trinisë së shenjtë i qoftë lavdi e ndera në shekuj të shekujve. Amen.

Dita Ndërkombëtare e Lutjes dhe Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Përkujtim Liturgjik i Shën Bakhitës, 8 Shkurt, 2017

Ata janë Fëmijë jo skllevër

Nga Alfred MATOSHI

Ata janë Fëmijë jo skllevër, kjo ishte Amotoja që bashkoi qindra besimtarë në Katedralen e Shën Palit në Tiranë në ditën e përkujtimit të Shën Bakhitës, ditë e njohur ndryshe edhe si dita ndërkombëtare e lutjes për viktimat e trafikimit në njerëz. Kjo shërbesë u organizua me datën 8 Shkurt 2017, nga një rrjet kongregatash dhe organizatash të njohura si “URAT”. Tema e këtij viti ishte e lidhur me fëmijet dhe të drejtat e tyre.

Kjo shërbesë ishte organizuar në mënyrë të

tillë që përveç lutjes, të kishin mundësi edhe të merrnin informacion ndërgjegjësues mbi trafikimin, punën skllavëruese, apo mohimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu pjesë e kësaj shërbesë ishin edhe shfaqja e një ekspozite me piktura të punuara nga fëmijët si dhe dy filma me metrazh të shkurtër, të krijuar posaqërisht për këtë ngjarje, dhe për këtë tematikë. Nuk mund të mungonin edhe fëmijët të cilët me entuziazmin dhe sinqeritetin e tyre u shfaqën përpara të pranishmëve me një kërcim gëzimi.

Në këtë shërbesë ishte i pranishëm edhe Arqipeshkvi i Tiranës dhe Durrësit, Mons. George Frenco, i cili gjatë fjalës së tij, bashkëndau eksperiencën mjaft prekëse nga historitë e viktimave të trafikimit, duke shprehur edhe ndjeshmërinë e tij të madhe ndaj këtij fenomeni dhe duke dhënë mesazhin e inkurajimit dhe të mbështetjes për organizatat që punojnë me këto viktime.

Ky është viti i dytë rradhazi që Rrjeti “URAT” organizon shërbesën e lutjes në ditën e Shën Bakhitës (ish viktime e trafikimit).

MIRËSEARDHJA DHE PREZANTIMI

Fjala përshëndetëse e Papa Françeskut,
8 Shkurt, 2015

“Të dashur motra dhe vëllezër, sot më 8 Shkurt, në përkujtimoren liturgjike të Shën Bakhitës, një motre Sudaneze, e cila kur ishte fëmijë përjetoj eksperiencën traumatike të të qenit një viktimë e trafikimit, Unioni Ndërkombëtar i Eprorëve të Përgjithshëm të Instituteve Fetare promovojnë Ditën e Lutjes dhe të Reflektimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Mbështes të gjithë ata që janë të përkushtuar në ndihmën ndaj burrave, grave dhe fëmijëve të skllavëruar, të shfrytëzuar dhe të abuzuar, shpesh të torturuar dhe të gjymtuar, si mjete kënaqësie. Unë shpresoj që personat me përgjegjësi në qeverisje do të mundohen seriozisht për të asgjësuar shkaqet e kësaj plage të turpshme; një plagë e padenjë për një shoqëri të civilizuar. Le të jemi secili prej nesh, të zotuar për të qenë një zë për të gjithë vëllezërit dhe motrat tona, të cilët janë turpëruar dhe deprivuar nga dinjiteti i tyre.” Le të lutemi të gjithë së bashku!

Lexuesi 1:

Ata janë fëmijë! Nuk janë skllavër!

Edicioni i tretë i Ditës Ndërkombëtare të Lutjes dhe Ndërgjegjësimit kundër trafikimit të njerëzve nxjerr në pah vuajtjet dhe shpresën e fëmijëve dhe adoleshentëve të trafikuar.

Sipas statistikave të fundit zyrtare të Kombeve të Bashkuara, një në tre viktima të trafikimit është fëmijë. Numri i personave të trafikuar që janë nën moshën 18 vjeç po rritet në mënyrë të qëndrueshme, në mbarë botën. Fëmijë dhe adoleshentë trafikohen për shfrytëzim seksual, punë e detyruar në shtëpi, martesë të detyruara, birësime të paligjshme, punë e detyruar, heqje organesh, lypje, vepra kriminale (si fëmijët ushtarë, trafikim droge) dhe praktika të magjisë.

Duhet urgjentisht të dëgjojmë të qarat e të vegjëlve, e të gjithëve, të çdo familje dhe komuniteti të cilët përjetojnë dhunën e shfrytëzimit dhe skllavërisë, të cilët janë të dëmtuar dhe të turpëruar.

Ne dëshirojmë që të bëhemi një rreze shprese për të gjithë fëmijët e trafikuar dhe familjet e tyre.

Ne deklarojmë se:

“Ata janë fëmijë! Nuk janë skllavër!”

Pas leximit të secilës prej këtyre statistikave shuhet një qiri.

Lexuesi 2: Në mbarë botën, 168 milionë fëmijë punojnë. Më shumë se gjysma e tyre, 85 milionë, bëjnë punë të rrezikshme. (ILO)

Lexuesi 3: Çdo vit, 22,000 fëmijë vdesin nga aksidentet në punë. 9% janë në industri, duke përfshirë punën në miniera dhe gurorë, industrinë përpunuese dhe të ndërtimit. (ILO)

Lexuesi 2: Numri i fëmijëve të përfshirë në konflikte të armatosura është rritur në rreth 300,000 gjatë dekadës së fundit. Moshë mesa-



tare e një ushtari fëmijë është 14 vjeç. 40 % e ushtarëve fëmijë janë vajza. (ILO)

Lexuesi 3: Dy milionë fëmijë i nënshtrohen prostitucionit në tregun global të seksit. (UNICEF)

Lexuesi 2: Miliona fëmijë shfrytëzohen në prostitucion dhe pornografi çdo vit anembanë botës, shumicën e kohës të mashtruar apo të shtyrë në situata të tilla, përmes premtimeve false dhe njohurive të kufizuara rreth risqeve të trafikimit. (UNICEF)

Lexuesi 3: 2527 fëmijë, nga moshë 0 deri në 18 vjeç, u identifikuan me njëfarë lidhjeje me rrugën, apo të cilët jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë në Shqipëri, Tetor 2014.

(Studim kombëtar mbi fëmijët në situatë rrugë në Shqipëri, UNICEF dhe Save the Children, me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). ARSIS, Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve dhe Instituti Kërkimor Growth for Knowledge (GfK).

Fjala e Zotit: Lexuar nga Imzot George Frendo OP, Arqipeshkëv i ArkiDioqezës Tiranë – Durrës.

“Prandaj, kushdo që e mëson ndonjërin prej këtyre të vegjëlve që besojnë në mua, të bëjë mëkat, për të do të ishte më mirë t’i varej për qafë guri i mullirit e të hidhej në fund të detit. (Mt 18:6; cf. Mk 9:42; Lk 17:2)

Në të vërtetë po ju them: çfarëdo që keni bërë për ndonjërin prej këtyre motrave dhe vëllezërve të mi më të vegjël, e keni bërë për mua.” Mateu 25, 40”

Lexuesi 4: Duhet të pranojmë se po bëhen shumë përpjekje për t’u dhënë fund këtyre krimeve kundër fëmijëve. Shumë njerëz janë duke bërë një ndryshim në botë:

Disa Kongregata të Motrave Rregulltare dhe Organizata Kishtarë ofrojnë mbrojtje dhe strehim për fëmijë dhe adoleshentë, të cilët i kanë mbijetuar trafikimit. Ata janë shpëtuar nga çdo formë shfrytëzimi dhe trafikimi. Strehëzat ofrojnë kujdes shëndetësor, psikologjik dhe edukues. Ata u mundësojnë fëmijëve që të ndërtojnë të ardhmen e tyre. Pas një periudhe kujdesi të plotë shëndetësor, shumë prej këtyre fëmijëve janë në gjendje t’u rikthehen familjeve të tyre.

Së bashku: “Në të vërtetë po ju them: çfarëdo që keni bërë për ndonjërin prej këtyre motrave dhe vëllezërve të mi më të vegjël, e keni bërë për mua.” Mateu 25, 40)

Lexuesi 5: Në 10 vitet e fundit, shumë organizata kanë promovuar veprimtari parandaluese për reduktimin e vulnerabilitetit dhe rrjedhimisht të rrezikut që njerëzit të trafikohen: Programe edukuese, bursa për fëmijë të varfër në zona rurale, programe për gjenerimin e të ardhurave, kujdes shëndetësor. Parandalimi është shndërruar në një fjalë kyçe për nxitjen e një ndryshimi të vërtetë në shoqëri, përmes dhënies së mundësive dhe alternativave ndaj fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Së bashku: Në të vërtetë po ju them: çfarëdo që keni bërë për ndonjërin prej këtyre motrave dhe vëllezërve të mi më të vegjël, e keni bërë për mua.” Mateu 25, 40)

Lexuesi 4: Në mbarë botën, organizata jofitimprurëse, organizata fetare dhe ato me bazë në komunitet, qeveri, lëvizje shoqërore dhe biznese forcojnë bashkëpunimin dhe punën në rreth, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim çrrënjosjen e trafikimit të njerëzve.

Së bashku: Në të vërtetë po ju them: çfarëdo që keni bërë për ndonjërin prej këtyre motrave dhe vëllezërve të mi më të vegjël, e keni bërë për mua.” Mateu 25, 40)



Lexuesi 5: Angazhimi i shumë organizatave dhe politikave sociale të shumë qeverive, ndihmojnë për reduktimin e numrit të të miturve që shfrytëzohen për punë. Numri global i fëmijëve që punojnë ka rënë me një të tretën që prej vitit 2000. Ndryshimi është i mundshëm!

Së bashku: Në të vërtetë po ju them: çfardo që keni bërë për ndonjërin prej këtyre motrave dhe vëllezërve të mi më të vegjël, e keni bërë për mua." Mateu 25, 40)

6 LUTJET E THJESHTA NGA FËMIJËT (pas çdo lutje ndizet një qiri) Lexuesi 6: I dashur Zot, ndihmoji të gjithë të miturit e shfrytëzuar. I dashur Zot, bashkoi me familjen dhe riktheju ëndrrat.

I dashur Zot, bëj që të realizohet vullneti yt për çdo fëmijë që vuan nga mënxyrat e më të rriturve.

I dashur Zot, shëro indiferencën tonë dhe na bëj të gatshëm të ndihmojmë vëllezërit dhe motrat tona të skllavëruara.

I dashur Zot, na jep fuqinë që të qëndrojmë kundër çdo padrejtësie dhe cënimi që i bëhet secilit fëmijë.

I dashur Zot, nxiti të rriturit të shohin në çdo fëmijë himnin e krijimit.

LUTJA E FUNDIT

O Zot, kur dëgjojmë për fëmijë dhe të rritur, të cilët mashtrohen dhe dërgohen në vende të panjohura për qëllime të shfrytëzimit seksual,

punës së detyruar dhe 'transplantimit' së organeve, zemrat tona trishtohen dhe shpirtrat na revoltohen, pasi dinjiteti dhe të drejtat e tyre përdhosen përmes kërcënimeve, mashtrimeve dhe forcës. Ne ngrejmë zërin kundra kësaj praktike djallëzore të skllavërisë moderne dhe lutemi me Shën Bakhitën që kjo praktikë të marrë fund. Na jep mençuri dhe kurajo që të qëndrojmë me ata, trupat, mendjet dhe shpirtrat e të cilëve janë plagosur kaq shumë, kështu që së bashku të mund të përmbushim premtimet e Tua për të mbushur këta vëllezër dhe motra me dashuri. Largo duarbosh shfrytëzuesit dhe bëj që ata të çlirohen nga kjo ligësi, si dhe na ndihmo të gjithëve ne që të marrim lirinë, e cila është dhuratë e jotja për fëmijët e tu. Amen

Po kungohemi me Jezusin, apo thjesht po hamë oste?

Nga Dom Marjan LUMÇI

Ndoshta nuk duket normale kjo që po them, por unë mendoj se është një çështje serioze dhe do thoja thelbësore për jetën e një besimtari.

O Zot...!

Jam kunguar me mijëra herë sepse kam marrë pjesë në mijëra Meshë deri tani... por çka ka ndryshuar në jetën time? Në çfarë kam ndryshuar?

Me u Kunguar, do me thënë me qenë i lidhur në mënyrë intime me Krishtin. Të kungohesh do me thënë të jetosh siç ka jetuar Ai!

Prej Kungimit të Parë e deri më sot, në çfarë ka ndryshuar jeta e jonë? Cilët kanë qenë hapat domethënës në rrugën e kthimit tonë? E thënë me një fjalë ndryshe, cilët kanë qenë frytet e shenjtërisë që Eukaristia ka realizuar në ne?

Shën Tereza e Avilës thoshte se mjafton vetëm një Kungim i marrur në Hirin e Zotit, pra pa mëkat, për tu shenjtëruar. E Lumja Imelda ka vdekë në ditën e Kungimit të Parë. Ka vdekë prej Dashurisë. Shumë shenjtërmomentin e Meshës e përjetonin në ekstazë të plotë, gjë e cila i ndodhte shën Injacit të Loyolës apo shën Jozefit nga Copertino...

Shumë persona vijnë dhe e marrin Kungimin në dorë, sepse ashtu është moda, dhe dukemi me trendy (edhe pse nuk është anti-liturgjike ajo



mënyrë). Por kush e merr mbi vetvete mëkatën e shkeljes së Trupit të Zotit nga personi që pas teje vjen për të marrë kungimin?!

Shpesh herë pjesëza të vogla të Trupit të Zotit duke kaluar nga një dorë tek tjetra rrezikojnë të bien në tokë dhe të shkelen "pa dashje" nga besimtarët të cilët nuk e vërejnë një gjë të tillë. Kush do ta lajë mëkatën e shkeljes së Zotit?

Shejtja Nanë Tereza dilte prej Meshet me një forcë dhe vullnet të jashtëzakonshëm për të ndihmuar të varfrit; Shejtja Gemma thoshte se sa

herë kungohej, kraharori i digjej nga një zjarr i pa shpjegueshëm; Shejti Shna Ndue për ta kthyer në fe një ateist, bëri që edhe gomari të binte në gjunjë para Ostes, ndërsa e Lumja Aleksandrina jetoi 13 vjet duke u ushqyer vetëm me një Oste të shuguruar në ditë.

Dhe për ta mbyllë shën Agustini thoshte se ne i metabolizojmë ushqimet që i hamë, POR PORSA I PËRKET EUKARISTISË, ËSHTË AJO QË NA METABOLIZON NE.

Sa është e vërtetë kjo gjë?

A të ka ndodhur ndonjëherë?

Dele të humbura, apo ujë grabitqarë?

Dëshmitarët e Jehovahit?!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI

vijon nga numri i aluar

FRIKËSIMI DHE MUNGESA E INTEGRIMIT

Nga viti 1960 deri me 1966 ritmi i rritjes së organizatës ra konsiderueshëm. Në këtë pikë Bibla e Kullës së Rojës dhe Shoqëria e Pamfleteve (BKR & SHP) botuan një libër të ri, me një datë të re për fundin e botës. “Jeta e Përrjetshme në Lirinë e bijve të Perëndisë” (1966) nga zëvendës-presidenti Franc (1894-1992), nxori përfundimin se vjeshta e 1975 do të shënonte fillimin e periudhës së shtatë në historinë e njerëzimit. Shoqëria u tregua shumë e kujdesshme në evitimin e botimit të një parashikimi haptas, por mesazhi ishte i qartë për Dëshmitarët e Jehovahit kudo ku ata ishin Armagedoni po vinte së shpejti. Disa madje shiten edhe shtëpitë dhe pasuritë e tyre dhe për këtë ata u lavdëruan nga udhëheqësit e tyre.

Radhët e tyre u rritën me mijëra deri në vitin 1975. Pastaj shumë Dëshmitarë e kuptuan se Shoqëria Kulla e Rojës nuk udhëhiqej nga Perëndia dhe u larguan nga organizata. Drejtuesit e BKR & SHP nuk e pranuan faktin se kishin gabuar në parashikimin e vitit 1975, përkundrazi, ata i udhëzuan anëtarët e çoroditur se duhej të “rregullonin pikëpamjet e tyre”.

Demaskimi i parashikimeve false të Shoqërisë Kulla e Rojës krijoi dyshime dhe shqetësime për organizatën. Shoqëria iu përgjigj duke botuar artikuj dhe libra në të cilat ata pranuan se kishin bërë gabime në parashikimet e tyre historike dhe në mësimet doktrinale. Ata i shfajësuan këto gabime duke ia atribuuar ato gabueshmërisë njerëzore dhe duke thënë se Shoqëria Kulla e Rojës kurrë nuk ka pohuar se ishte e frymëzuar nga Perëndia. Ky ishte një mashtrim i paturpshëm meqenëse revistat e Kullës së Rojës në të kaluarën janë paraqitur si “Mesazhe të Perëndisë” dhe kanë pasur udhëzime në thonjëza nga Jehovahi. Një revistë e Kullës së Rojës jo me larg se 1 Gushti 1995 citonte: “Jehova veçanërisht mëson njerëzit e tij me anë të studimeve javore të Biblës, duke përdorur Kullën e Rojës si ndihmues në mësim”

Në vitin 1943, zëvendës-presidenti i KR Frederik Franc, dhe presidenti Nejthen H. Norr dhanë nën betim, në gjyq, dëshminë e mëposhtme se përmbajtja e Kullës së Rojës vjen direkt nga Perëndia.

Marrja në pyetje Frederik W. Franc në hetimin e *Olin Mojl kundër BKR & SHP*, 1943. Seksioni # 2596-2597 faqe 866.

Pyetje: Sidoqoftë, Jehova Perëndi është tani botuesi i gazetës (*Kulla e Rojës*), apo jo?

Përgjigje: Ai është sot botuesi i gazetës.

Pyetje: Sa kohë ka qenë botuesi i gazetës?

Përgjigje: Që nga fillimi, Ai e ka drejtuar atë. Marrja në pyetje e Nejthen Honer Norr gjate hetimit të *Olin Mojl kundër BKR & SHP*, 1943, Seksioni # 4421, faqe 1474.

Pyetje: Në fakt, ajo (*Kulla e Rojës*) është konsideruar si Fjala e Perëndisë, apo jo?

Përgjigje: Po. Si Fjala e Perëndisë.

Pyetje: Pa asnjë kualifikim të çfarëdoshëm?

Përgjigje: Po, drejtë.

Shumë njerëz nuk janë në dijeni të këtyre fakteve dëmtuese dhe kështu radhët e Dëshmitarëve shtohen duke shpërndarë sasi të mëdha materiale mashtruese. Pavarësisht nga dështimet në të kaluarën dhe pretendimet e sotme të pafrymëzuara, Shoqëria Kulla e Rojës sërisht kërkon besnikëri të plotë dhe vazhdon të parashikojë se Armagedoni po vjen së afërmi për shfarosjen e çdo njeriu që nuk bashkohet me organizatën ose të atij që e braktis atë. Megjithatë me një histori të ndryshuar për manipulime dhe profeci të rreme, Shoqëria Kulla e Rojës ende parashikon se është e vetmja që mëson të vërtetën.

BESIME DOKTRINALE

Kur një organizatë si BKR&SHP pretendon të jetë e vetmja fe e vërtetë dhe burim i vetëm i mësimit korrekt të Biblës, duhet të studiojmë besimet e saj me kujdes. Nëse doktrinat janë të vërteta, ato duhet të jenë të mbështetura në Bibël dhe mësimet e saj do të jenë të qëndrueshme dhe të pandryshueshme në

vite. Por Dëshmitarët e Jehovahit mohojnë ose ndryshojnë shumë nga mësimet bazë të Biblës dhe besimet e tyre janë të kundërta me ato të krishterëve të rilindur gjatë shekujve. Shikoni krahasimet e mëposhtme:

Natyra e Hyjit. Bibla mëson se ka vetëm një Hyj të vërtetë Is. 43.10-11, 44.6-8). Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjte janë të identifikuar si persona të veçantë në një Trinitet me Perëndinë në krye. (Mat 3:16-17, 2 Kor 13:14). Në Dhiatën e Re, Biri dhe Fryma e Shenjte, ashtu si Ati janë identifikuar si Perëndi të veçantë. Secili ka attribute hyjnore dhe vepron si Perëndi. (Biri: Mark 2.5-12, Gjoni 20.28, Heb 1.8, Fryma e Shenjte: Veprat 5.3-4, 2 Kor 3.17-18).

Në të kundërt, BKR&SHP mohon natyrën e trinitës së Perëndisë dhe mësojnë se një dogme e tillë është frymëzuar nga djalli. Ata mësojnë se Jahve, emri i Perëndisë se vetëm e të vërtetë, i korrespondon vetëm Perëndisë-Atë. Shoqëria, gjithashtu mohon se Jezusi është Zot (shih pikën tjetër). Ata mohojnë se Shpirti i Sjejtë është një person dhe në vend të kësaj mësojnë se Ai është thjesht një forcë aktive e Hyjit, e ngjashme me elektricitetin.

Jezu Krishti. Bibla mëson se Jezu Krishti është Zoti i bërë njeri (në mish) dhe Ai është krijuesi i të gjitha gjërave (Gjoni 1:1-3, 14, Kol:16). Ndërkohë që ishte Zot, në kohën e caktuar, Ai la mënjatë lavdinë që ndante me Atin dhe mori natyrë njerëzore (Gjoni 17:3-5; Fil. 2:6-11; Kol2:9).

-vijon në numrin e ardhshëm-





Përgjigje e Bashkuar Kundër Trafikimit

Deklaratë

Ata janë fëmijë! Nuk janë skllëvër!

Rrjeti URAT (United Response Against Trafficking, Përgjigje e Bashkuar Kundër Trafikimit) është i vendosur të luftojë kundër trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore.

Si një Rrjet Kombëtar i përbërë nga organizata dhe Kongregata të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ne kemi si qëllim të luftojmë trafikimin në njerëz dhe për më tepër trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Këtë vit, më shumë se kurrë, ne jemi të vendosur të qëndrojmë të bashkuar në misionin e përbashkët: të mbrojmë fëmijët dhe të ofrojmë një jetë më të mirë për ta. Statistikat mbi fëmijët në rrezik trafikimi dhe shfrytëzimi në Shqipëri janë alarmante. 2527 fëmijë, nga mosha 0 deri në 18 vjeç, u identifikuan në njëfarë lidhjeje me rrugën, apo të cilët jetojnë dhe/ose punojnë ne rrugë. (*Studim kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, UNICEF dhe Save the Children Shqipëri 2014*)

Nga raporte të organizatave që punojnë në Shqipëri, shifrat e rasteve të fëmijëve në rrezik janë edhe më të larta dhe evidente.

”Trafik personash” nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim apo pritje të personave, me anë kërcënimit apo përdorimit të forcës apo formave të tjera të detyrimit, të marrjes me forcë, të mashtrimit, të gënjeshtërisë, të abuzimit me pushtetin ose të shfrytëzimit të një pozicioni delikat, apo të marrjes apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme, apo dhënies së pagesave apo përfitimeve të ndryshme për të arritur pranimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi duhet të përfshijë, si minimum, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose të formave të tjera të detyrimit, të punës apo shërbimeve të detyruara, të skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë apo të heqjes së organeve. *“Protokolli i Palermos”, viti 2000.*

Rrjeti URAT është i vendosur në misionin e tij për të luftuar trafikimin duke punuar së bashku për të pasur një zë më të fuqishëm. Ky vit është koha për të ngritur zërin në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe të ndalojmë trafikimin dhe abuzimin. Ne ju ftojmë që të punojmë në këtë mision së bashku dhe të ndihmojmë fëmijët të jetojnë fëmijërinë.

Ata janë fëmijë! Nuk janë skllëvër!

